

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
i
"MOAN" Shpk**

KAPITULLI I

Emri, Forma, Selia, Kohezigjatja

Neni 1

Data e Themelimit dhe Emri

- 1.1. Sot me date 21.02.2024 themelohet nga ortaku/ortaket themelues, sipas legjislacionit shqiptar, shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "MOAN" (ne vijim "Shoqeria"), e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk".
- 1.2. Ortaku/Ortaket i/e Shoqerise ("**Ortaku**"/"**Ortaket**") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuote/a.
- 1.3. Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga :

- fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk".
- numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj.
- adresa e regjistruar;
- pasqyrimi i faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, nese aplikohet.
- kapitalin e regjistruar dhe te paguar te Shoqerise.

Neni 2

Forma Ligjore

- 2.1. Shoqeria eshte nje person juridik shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("shoqeri me pergjegjesi te kufizuar"), ne pajtim me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("**Ligji per Shoqerite Tregtare**").

Neni 3

Selia

- 3.1. Ne momentin e nenshkrimit te ketij akti, selia e Shoqerise ndodhet ne adresen:
 - Mjull Bathore me nr. pasurie 992/8 ND, vol. 27, F.210 Njesia administrative Farke, Tirane
- 3.2 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjetër te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.



Neni 4
Kohezgjatja

4.1. Kohezgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 5
Emblema, Vula

5.1. Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratori i shoqërisë.

5.2. Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

5.3. Te gjitha dokumentat e shoqërisë duhet të përmbajne emblemen dhe vulën e saj.

KAPITULLI II

Neni 6
Objekti i Shoqërisë

6.1. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është kryerja e çdo aktiviteti tregtar të lejuar nga legjislacioni Shqiptar, dhe veçanërisht:

- Konsulencë për menaxhim biznesi, marketing, shërbime konsulencë të bazuara në analizën e tregut, analizë të riskut, shërbime ndërmjetësimi në tregun e punës për qytetarë shqiptarë dhe të huaj. Shoqëria do të sigurojë informacione, përfaqësim dhe konsulencë dhe ndërmjetësim në sektorin e burimeve njerezore, me referim të vlerësimit të kërkesave dhe kërkesave për ndërmjetësim për punësim në vendet e Bashkimit Europian dhe jo vetëm;
- Shoqëria mund të zhvillojë shërbime konsulencë ndaj shoqërive shqiptare e të huaja, duke përfshirë shërbimin e promovimit të shërbimeve dhe produkteve të tyre;
- Çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji në Republikën e Shqipërisë.

6.2. Përveç kësaj në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperm.

Neni 7
Ndryshime

7.1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.



KAPITULLI III
Kapitali Themeltar; Kuotat e Kapitalit Themeltar

Neni 8
Kapitali Themeltar

8.1. Kapitali i Shoqerise eshte ne total (100 (njqind) Leke) i zoteruar teresisht ne 1 (nje) kuote/a (me tej "Kuota"/"Kuotat")

Neni 9
Ortaku/Ortaket dhe Kuota/Kuotat

9.1. Ne daten e themelimit Shoqeria ka 1 (nje) Ortake i cili/te cilet ka nenshkruar dhe zoterojne Kuoten/Kuotat e Shoqerise, si meposhte:

- Monia Lenardon, shtetase italiane, e bija e Mario , lindur me 13.10.1972, ne Velletri Roma, Itali dhe banuese ne Itali, Via delle Selve, Nr. 25, Lanuvio, Roma (RM), mbajttese e kartes se identitetit te Republikes se Italise, Nr. CA32760DG, zoteruese e 100% te kapitalit themeltar te shoqerise me nje kuote te vetme ne vleren 100 lek.

Neni 10
Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

10.1. Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Ortakeve ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit per Shoqerite.

10.2. Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit.

10.3 Rritja e kapitalit do te behet me leshimin e kuota te reja apo me rritjen e vleres se kuotave ekzistuese. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkruhen dhe vlere e tyre do te paguhet plotesisht.

10.4. Shoqeria nuk mund te bleje asnje kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Ortaket mund te autorizojne Administratorin/ret te bejne blerjen e kuotat perkatese apo pjese te tyre dhe ti anulojne ato.

Neni 11
Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

11.1. Ortaket jane vetem ata te cilet zoterojne kuota ne Shoqeri.

11.2. Çdo Ortak do te kete te dejta vote ne perpjestim me perqindjen e kontributit te zoteruar prej tij ne kapitalin e Shoqerise dhe qe perfaqesohet nga Kuota e tij ose pjese e Kuotes se tij. Çdo Ortak ka te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, sikunder te drejtat e parashikuara nga ky Statut, dhe dispozitave ligjore te Ligjit per Shoqerite.

11.3. Ortakut do t'i jepen, pas kerkeses me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.



11.4. Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotes/tave, transferohen tek çdo zoterues i ri per keto Kuota.

11.5. Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaku mban pergjegjesi brenda limitit te vleres se Kuotes qe zoteron. Ortaku nuk mban pergjegjesi mbi vleren e investimit te tij ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata leshojne).

11.6. Shoqeria nuk mban pergjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te tij.

KREU IV

Asambleja e Ortakeve/Ortaku i Vetem

Neni 12 Kompetencat

12.1. Asambleja/Ortaku i Vetem eshte organi vendim marres i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

Neni 13 Mbledhja

13.1. Asambleja/Ortaku i Vetem duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.

13.2. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

13.3. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjitha aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja/Ortaku i Vetem do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t'i paraqitet, pervec rastit kur kjo blerje behet ne burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

13.4. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga ortaku pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

13.5. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asambleja/Ortakut te Vetem i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

13.6. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asambleja/Ortaku i Vetem mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e Administratoreve.

Neni 14 Menyra e Thirrjes

14.1. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara tij nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

14.2. Asambleja/Ortaku i Vetem mund te mblidhet nga nje prej Administratoreve ose me iniciativen e tij.

14.3. Asambleja/Ortaku i Vetem mblidhet ne seline e Shoqerise, ose ne ambientet e deges se Shoqerise apo ne cdo qytet, province apo shtet tjetet, siç bihet dakord nga Asambleja/Ortaku. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve i njoftohet Ortakut/Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes, ose ndermjet adreses email te percaktuar ne kete statut, se bashku me dokumentat e nevojshme te lidhura me ceshtjet e rendit te dites. Ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem nuk eshte mbledhur/thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem eshte dakort.

14.4. Asambleja/Ortaku i Vetem mund te vendose te zhvilloje Mbledhjen edhe nepermjet videotelefonatave sipas menyrave te percaktuara ne njoftimin e thirrjes sipas nenit 14.3.

14.5. Ortaku gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetet ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

14.6. Ortaku ka te drejten te votoje ne perputhje me vleren e Kuotes se zoteruar prej tij ne kapital.

14.7. Vendimet e meposhtme do te merren me nje kuorum prej me shume se $\frac{1}{2}$ e kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje:

- vendimet ne lidhje me mos shperndarjen e fitimeve apo/dhe me destinacionin e ndrshem te fitimeve te Shoqerise;
- ndryshimi i Statutit;
- likujdim ose riorganizmin e Shoqerise;
- zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise;

Çdo vendim tjetet do te merret me nje kuorum prej me shume se 30% te kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne 51% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje.

14.8. Ortaku/Ortaket do te njoftohen per permbajtjen e axhendes se mbledhjes.

14.9. Administratori/ret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit per Shoqerite dhe do te regjistrojne te gjitha vendimet e marra ne Regjistrin e Vendimeve.

Neni 15 **Perjashtimi nga e drejta e votes**

15.1. Nje Ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur eshte duke vendosur mbi:

- vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
- shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
- dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

15.2. Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.



KREU V
Administratori/ret

Neni 16
Administratoreve dhe kompetencat

16.1. Shoqeria mund te administrohet nga nje ose me shume Administrator/re, sipas vendimit te Asamblese/Ortakut te Vetem. Administratori/ret mund te jete i çdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jete rezident ne Shqiperi.

16.2. Ne momentin dhe per qellimin e miratimit te ketij statuti administrator i Shoqerise eshte:

● Z. Andrea Di Gregorio, i biri i Saverio, shtetas italian, lindur me 30.07.1972, banues ne Via Giovanni Prati, Nr. 5, Marino, Roma, Itali, mbajtes i kartes se identitetit te Republikes se Italise Nr. CA70556LU, i cili emerohet per nje periudhe prej 5 (pese) vjetesh nga data e themelimit te Shoqerise, te percaktuar ne kete dokument. Çdo ndryshim i mepaseshem ne lidhje me emerimin e Administratorit/reve nuk do te konsiderohet si nje ndryshim Statuti.

16.3. Administratori/ret emerohen per nje periudhe prej 5 (pese) viti/vjetesh, te rinovueshme. Ne rast te me shume se nje Administratori kompetencat e qe do te ushtrohen vecmas nga secili prej Administratoreve, nese ky eshte rasti, do te percaktohen ne vendimin e Asamblese/Ortakut te Vetem qe emerone Administratorin.

16.4. Menjehere pas pranimit te emerimit te tij/tyre, Administratori(et) njohin ne se marredhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje vendimi te Asamblese/Ortakut i Vetem gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre nga puna, ne perputhje me ligjet perkatese.

16.5. Asambleja/Ortaku i Vetem ka te drejte te shkarkoje Administratorin(ret) ne cdo moment.

16.6. Nese Administratoret e Shoqerise nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, çeshtja do te referohet tek Asambleja/Ortaku i Vetem.

16.7. Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria mund t'u rimbursoje Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Admnsitratorit(eve) ne vende qe nuk jane brenda qytetit te residences se Administratorit(eve).

Neni 17
Kompetencat dhe detyrimet e Administratorit/reve

17.1. Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- (i) kerkesa/thirrjeja e mbledhjes se Asamblese/ Ortakut te Vetem, ne rastet e specifikuar ne nenin 13;



- (ii) menaxhimin e aktivitetit te perditshem tregtar te Shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja/Ortaku i Vetem;
- (iii) perfaqesimin e Shoqerise me palet e treta;
- (iv) kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise;
- (v) pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim tek Asambleja/Ortaku i Vetem;
- (vi) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare e Biznesit, kur eshte e nevojshme;
- (vii) raportimin perpara Asamblese/Ortakut te Vetem, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;
- (viii) kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Asambleja/Ortaku i Vetem.

17.2. Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaku ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaku.

Neni 18

Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia

18.1. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,16,17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, administratoret detyrohen:

- (i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
- (ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- (iii) te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
- (iv) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;
- (v) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

18.2. Administratoret pergjigjen kundrejt shoqerise per cdo veprim apo mosveprim, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.

18.3. Ne rast te shkeljes se detyres dhe standardeve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se

kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.

18.4. Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqoftese ne kundershtim me Ligjin per Shoqerite kryen veprimet e meposhtme:

- (i) i kthen Ortakeve kontributet;
- (ii) i paguan Ortakeve interesa apo dividente;
- (iii) i shperndan asetet Shoqerise;
- (iv) lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitein e saj, kur duhet ta kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj;
- (v) jep hua;

KREU VI
Administrimi Financiar i Shoqerise
Neni 19
Eksperti Kontabel i Autorizuar

19.1 Ortaku cakton ekspertin kontabel te autorizuar (auditues) per te dhene sherbimet e tij kudrejt Shoqerise.

19.2. Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII
Aktiviteti Shoqerise

Neni 20
Viti ekonomiko-financiar

20.1. Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-t te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

Neni 21
Mbajtja e Llogarive

21.1. Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

Neni 22
Llogaritja dhe Shprendarja e Fitimit

22.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te pasqyrave financiare te aprovuar nga Asambleja/Ortaku i Vetem. Cdo ndryshim ne destinacionin e fitimit do te caktohet nga Asambleja/Ortaku i Vetem ne perputhje me Statutin dhe me ligjet e zbatueshme.

22.2. Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:

- (i) asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;
- (ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem;

22.3. Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.2 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush kerkesat sipas 22.2, Administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

22.4. Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

KREU VIII **Modifikimi i Formes Ligjore dhe Prishja**

Neni 23 **Modifikimi i Formes Ligjore**

23.1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese/Ortakut te Vetem ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

23.2. Shoqeria do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit te nevojshme ne Shqiperi per kete qellim.

Neni 24 **Prishja e Shoqerise**

24.1. Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:

- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) me vendim te Asamblese/Ortakut te Vetem;
- (iii) me hapjen e nje procedure falimentimi;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (v) me vendim gjykate;
- (vi) per arsye te tjera te parashikuara nga Asambleja/Ortaku i Vetem ne cdo kohe.

24.2. Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njoftimin vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

KREU IX **Te ndryshme**

Neni 25 **Largimi i Ortakut**

25.1. Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga dispozitat nr. 101, 102, 103 te Ligjit per Shoqerite Tregtare.



Neni 26
Te tjera

26.1. Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

MONIA LENARDON

